



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1268/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), kundër vendimit të PZAP-it, me numër Anr.1008/2013 të datës 04.12.2013, në seancën e panelit të mbajtur me 10.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si i pabazuar apeli nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një apel nga LVV, me datën 06.12.2013 për rishikim të vendimit Anr.1008/2013 të datës 04.12.2013 në të cilën pretendon se PZAP-i nuk ka vërtetuar në mënyrë të mjaftueshme bazën faktike dhe në këtë mënyrë baza për shqiptimin e gjobës nuk ka përmbushur kushtin thelbësor që të vërteton gjendjen faktike në mënyrë të plotë. Vlen të theksohet se administrimi i provave nuk nënkupton vërtetimin e gjendjes faktike, andaj për të njëjtën duhet shqyrtuar materialin që i është ofruar PZAP-it në cilësinë e provës që i është bashkëlidhur përgjigjes në ankesë nga LVV. Ky material përfshinë kontratën elektronike e cila kushtëzon hapjen e llogarisë në rrjetin social Facebook dhe është kontratë e dyanshme që lidhet në momentin e hapjes së llogarisë. Poashtu PZAP-i në asnjë vend të arsyetimit të arsyetimit të vendimit nuk ka provuar pronësinë e llogarisë së shkelësit të supozuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj apelin gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore lidhur me vendimin Anr.1008/13 të datës 04.12.2013 se PZAP-i nuk ka ofruar bazën ligjore, nuk qëndrojnë, sepse secili subjekt politik është përgjegjës për shkeljet e Kodit të Mirësjelljes që kryhet nga anëtarët, mbështetësit dhe kandidatët e tyre, siç përcaktohet me nenin 32.5 të LZP-së.

Në rastin konkret Albulena Haxhiu nga Lëvizja Vetëvendosje ka rënë në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika b) në cilin parashihet:

Njëzetekatër (24) orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë:

b) bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Siç shihet nga dispozita e sipërsëhënuar ligjore nuk përcaktohet se çfarë fushate është e ndaluar apo me çka do të bëhet fushatë (telefon, facebook, twitter etj), por theksohet se bërja e fushatës në çfarëdo mënyre gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore është e ndaluar, andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1268/2013 më datën 10.12.2013



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24(njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.